



## TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.71

Njësia e Vendosur në Tender Nr.25

NPB Malishgan Parcelat 244-1 dhe 245-4 ZK Dranashiq

Emri i NSh.-së	NPB Malishgani, Klinë në likuidim ("Ndërmarrja") Fi.265/90
Lloji i shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur
Dita e Ofertimit	Më 16.04.2025 nga ora 10:00h deri 12:00h në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë
Çmimi minimal	Ritenderim
Depozita e Ofertës	€ 1,500
Kategoria potenciale për shfrytëzim	Rezidenciale
<b><u>Përshkrimi i Aseteve</u></b>	
Vendndodhja e Aseteve	Zona Kadastrale Dranashiq, Komuna Klinë Të dhënat e hartës ©2024 Google <a href="#">Shikoni këtë pronë në Google Maps</a> Aktmohim: Vendndodhjet e treguara nga PIN-at në Google Maps ofrohen vetëm për qëllime të orientimit dhe referencës së përgjithshme. Këto mund të mos pasqyrojnë saktësisht vendndodhjen, kufijtë ose veçori të tjera të asetëve të përshkruara. Përdoruesit këshillohen të verifikojnë në mënyrë të pavarur të gjitha vendndodhjet për çdo çështje që kërkon saktësi ose informacion me rëndësi ligjore.
Ndërtesat dhe tokat	Kjo shitje përfshinë parcelën kadastrale me nr.244-1 me sipërfaqe prej 501m <sup>2</sup> me kulturë tokë ndërtimore Shtëpi-Oborr si dhe parcelën kadastrale nr.245-4 me sipërfaqe prej 681m <sup>2</sup> me kulturë Arë e klasës 5, në sipërfaqe të përgjithshme 1182 m <sup>2</sup> (11ari 82m <sup>2</sup> ), në ZK Dranashiq, komuna Klinë. <b>Shënim i rëndësishëm:</b> Edhe pse sipas certifikatës parcela nr.244-1 është me kulturë objekt, sipas gjendjes në teren nuk ekziston objekt në këtë parcelë. Parcelat nuk kanë qasje në rrugë publike.
Shfrytëzuesit	Toka nuk është e punuar.
Asetet tjera	Nuk ka.
Detyrimet që do të barten	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.



Foto/fotot  
ose informata të tjera  
për asetet në shitje




Informatat rreth Njesisë lëndë e shitjes të prezantuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org).



**RAPORT I VIZITËS NË TERREN**  
**NPB MALISHGAN-Parcelat Kadastrale 244-1, 245-4**

Me datë 04.10.2024 zyrtarët e AKP- ZR Pejë vizituan tokat bujqësore që evidentohen në pronësi të NPB Malishgan, K.K Klinë.

Parcelat kadastrale janë të regjistruara në certifikatën e pronësisë me nr të njësisë P-71006011-00244-1 me sipërfaqe prej 501 m<sup>2</sup> me kulturë Tokë ndërtimore Shtëpi-Oborr, P-71006011-00245-4 me sipërfaqe prej 681 m<sup>2</sup> me kulturë Arë e klasës 5, sipërfaqja e përgjithshme është **1182m<sup>2</sup>** Z.K Dranashiq.



Ortofoto, fotografi e terrenit parcelat kadastrale 244-1, 245-4

Nga gjendja faktike në teren konstatuam se:

- Parcelat kadastrale me nr të njësisë 244-1, 245-4 shtrihen në anën perëndimore të zonës kadastrale Dranashiq.
- Në parcelën kadastrale vërehet se ka mospërputhje e sipërfaqës tekstuale 681m<sup>2</sup> (në certifikatë pronësore) dhe asaj grafike 761m<sup>2</sup> ( sipas kufijëve kadastral).
- Nuk ekziston asnjë objekt në parcelën kadastrale 244-1.
- Parcelat e lartëshënuara nuk kanë qasje në rrugë publike.
- Nuk janë të punuara.

Zyrtare Kadastrale Rajonale  
Blerta Jashari Kastrati

Zyrtare e operacioneve për administrim të aseteve:

Lindita Agushi

**Raporti i vizitës në teren**

**Informatat dhe  
Dokumentet e Ofertimit**

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik  
Tel: +383 (0) 38 500 400 lok.1090,2059  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)  
Agjencia Kosovare e Privatizimit  
Rr. Dritan Hoxha, nr.55  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës